



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1539, datë 31.03.2011

Për

“Shqyrtimin e ankimimit administrative të Eagle Mobile sh.a në lidhje me Aktin Administrativë, Vendimi nr. 1467, datë 23.12.2010 të Këshillit Drejtues të AKEP “Për miratimin e ofertës referencë të interkoneksionit të Eagle Mobile sh.a”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 31.03.2011, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Shqyrtimin e ankimimit administrative të Eagle Mobile sh.a në lidhje me Aktin Administrativë, Vendimi nr. 1467, datë 23.12.2010 të Këshillit Drejtues të AKEP “Për miratimin e ofertës referencë të interkoneksionit të Eagle Mobile sh.a”

BAZA LIGJORE:

1. Germa ç) e nenit 8, neni 31 e vijues, pika 1 e nenit 114 dhe pika 1 e nenit 115 te ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**ligji nr. 9918**);
2. Pika 2 e nenit 137, neni 138 e vijues i ligjit nr. 8485, date 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (**K.Pr.A**)
3. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendëshme të AKEP, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918 (**Rregullorja e Brendshme**);

4. “Rregullore per analizen e tregut”, miratuar me Vendim te Keshillit Drejtues nr. 747, date 17.07.2009 (**Rregullorja**);
5. Rregullore per Aksesin dhe Interkoneksionin miratuar me VKD nr. 1300, datë 14.06.2010 e ndryshuar (**Rregullorja**);
6. Vendimi nr. 1467, datë 23.12.2010 të Këshillit Drejtues të AKEP “Për miratimin e ofertës referencë të interkoneksionit të Eagle Mobile sh.a” (**Vendimi**);

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Shkresa nr. 250 prot, datë 21.01.2010 e Eagle Mobile sh.a (AKEP nr. 97 prot, datë 21.01.2010) “Ankimi Administrativ”, (**Ankim Administrativ**);
2. Vendimi nr. 1467, datë 23.12.2010 të Këshillit Drejtues të AKEP “Për miratimin e ofertës referencë të interkoneksionit të Eagle Mobile sh.a” (**Vendimi**),
3. Projektvendim i KD të AKEP për “Shqyrtimin e ankimimit administrativë të Eagle Mobile sh.a në lidhje me Aktin Administrativë, Vendimi nr. 1467, datë 23.12.2010 të Këshillit Drejtues të AKEP “Për miratimin e ofertës referencë të interkoneksionit të Eagle Mobile sh.a” (**Projektvendimi**);
4. Relacion shpjegues mbi projektvendimin (**Relacioni**);
si dhe,
5. Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

- I. Eagle Mobile sh.a me shkresën nr. 250 prot, datë 21.01.2010 (AKEP nr. 97 prot, datë 21.01.2010) brënda afatit ligjor të përcaktuar ne nenin 140 të Ligjit nr.8485, ka bërë ankim administrativ për ndryshim të Vendimit nr. 1467, datë 23.12.2010 të KD të AKEP duke sqaruar se:
 1. Oferta Reference e Interkoneksionit (këtu e më poshte ORI) e miratuar nga AKEP me VKD nr. 1467 është një dokument i ndryshëm nga draft ORI që Eagle Mobile ka depozituar në AKEP me shkresën nr. 3914 prot, datë 13.09.2010 në zbatim të Vendimit nr. 1346, datë 23.07.2010;
 2. Eagle në hartimin e draft ORI-t të datës 13.09.2010 është bazuar në marrëveshjen ekzistuese të Interkoneksionit në kuadrin rregullator si dhe në Vendimet përkatëse të AKEP mbi shpalljen e Eagle Mobile OFNT;
 3. Eagle Mobile konsideron se, AKEP duhet të kishte shprehur qëndrimin e vet lidhur me ORI e datës 13.09.2010 përpara se të ndryshonte plotësisht ORI për të gjithë operatorët FNT;
 4. Gjithashtu Eagle vlerëson se AKEP ka lejuar nënshkrimin e MI ndërmjet operatorëve duke mos vërejtur se ORI nuk plotëson kërkesat që lidhen me kushtet e veçanta për ndershmërinë, transparencën, mosdiskriminimin etj;

5. Eagle Mobile thekson se komentet e Eagle të depozituara në AKEP me datë 16.12.2010 në përgjigje te ORI të publikuar nga AKEP me datë 06.12.2010, nuk janë marrë në konsiderat nga AKEP ndryshimet e propozuara mbi pikat e ORI si më poshtë vijon:
 - Pika 3 “Përkufizime dhe interpretimet”,
 - Pika 6 “Shërbimet e interkoneksionit”
 - Pika 8 “Kërkesa për shërbimi Interkoneksion”;
 - Pika 13 siguria e personelit dhe instalimeve/Ruajtja e integritetit të rrjetit;
 - Pika 17 “Dhënia e informacionit”;
 - Pika 20 “Shkelja, pezullimi dhe zgjidhja e mosmarreveshjes së interkoneksionit”;
 - Aneksi III “Faturimi dhe Pagesat” pika 3.2.3 “Faturimi për shërbimet e Eagle Mobile në lidhje me trafikun”;
 - Aneksi V Numeracioni dhe CLI
 - Eagle në lidhje me SLA, sygjeron të rishikohen dhe rregullohen në mënyrë të qartë dhe të detajuar duke përcaktuar sanksionet e dhëna për kapacitetet si dhe të jepet një përshkrim i detajuar në formën e skemës për procedurat dhe sanksionet në rastet e shkeljes së detyrimeve me CLI;
6. Eagle konsideron se AKEP bazuar në pikën 3 të nenin 52 të Ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008, në ORI e Eagle nuk është përcaktuar vlefshmëria dhe kohëzgjatja minimale/maksimale, dhe se AKEP domosdoshmërisht duhet të përcaktojë kohëzgjatjen minimale në përmbushje të dispozitave ligjore;
7. Për sa më sipër Eagle i kërkon AKEP:
 - Të marrë në konsideratë kërkesën për rishikim dhe ndryshim të Vendimit nr. 1467 date 23.12.2010 për miratimin e ORI të Eagle Mobile;
 - Të miratojë ORI e publikuar më datë 06.12.2010 duke përfshirë komentet e lartpërmëndura;
8. Ankimimi administrativ në lidhje me VKD nr.1467, date 23.12.2010, pezullon efektet e tij, nga data e depozitimit të ankimimit në AKEP deri në marrjen e një vendimi përfundimtar të AKEP mbi ankimimin administrativë;
- II.** AKEP, bazuar në shqyrtimin e pretendimeve të ankimit administrativë të Eagle Mobile në lidhje me Vendimin nr. 1467, datë 23.12.2010 të AKEP, gjykon se:
 1. AKEP, mbi pretendimin që ngre Eagle Mobile në paragrafin e parë dhe të dytë të ankimit të tij, çmon se jemi në kushtet e zbatimit të pikës 3 të nenit 52 të Ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektromike në Republikën e Shqipërisë”, pasi e ka kontrolluar ligjshmërinë dhe rregullsinë e saj ka konstatuar se oferta referencë e paraqitur nga Eagle Mobile, nuk i plotëson kërkesat që lidhen me kushtet e veçanta, për ndershmërinë, mosdiskriminimin, transparencën, arsyeshmërinë dhe grafikun kohor, ne këtë mënyrë ka çmuar të imponojë ndryshimin e ofertës referencë të paraqitur, duke dalë me Vendimin nr. 1467, datë 23.12.2010 të Këshillit Drejtues të AKEP “Për miratimin e ofertës referencë të interkoneksionit të Eagle Mobile sh.a”;

2. AKEP, në lidhje me pikën 3 “Përkufizimet dhe interpretimet”, ka gjykuar dhe çmuar si të drejtë renditjen e kuadrit ligjor dhe rregullator të paraqitur në ofertën referencë të Eagle Mobile, të miratuar dhe në fuqi. Aktet e cituara në ofertën e miratuar nga AKEP, i referohen akteve më të rëndësishme për marrëdhëniet e interkoneksionit dhe mosmarrveshjeve që mund të lindin midis palëve. Kjo nuk përjashton përdorimin e akteve të tjera rregullatore në fuqi;
3. Në lidhje me pikën 6 “Shërbimet e interkoneksionit”, ku përcaktohet “Për të shmangur çdo dyshim në lidhje me Marrëveshjen e interkoneksionit, asnjë nga palët nuk ka detyrimin të përcjellë thirrje të çfarë do lloj kategorie në rrjetin e palës tjetër” AKEP konsideron që pretendimi i Eagle Mobile mbi paqartësin e këtij paragrafi është i drejtë dhe merret në konsideratë;
4. AKEP, pretendimin e Eagle për shtimin dhe rregullimin e pikës 8 “Kërkesa për shërbim interkoneksionit”, e konsideron si të pa bazuar, pasi vlerëson se kjo pikë është në përputhje dhe në zbatim të nenit 7 të Rregullores “Për Aksesin dhe Interkoneksionin” miratuar me VKD nr. 1300, datë 14.06.2010 e ndryshuar;
5. Në lidhje me sygjerimin e Eagle Mobile për shtimin e paragrafit:

“Palët kanë të drejtë të kërkojnë në listën e dokumentacionit edhe kopje të certifikatës së konformitetit, lëshuar nga AKEP”

AKEP vlerëson se pika 13 e RIO është në zbatim të Rregullores nr. 1, datë 27.07.2001 “Për pajisjet radio dhe fundore të telekomunikacionit”, e ndryshur me VKD nr. 1396 datë 28.08.2010, konkretisht në pikat 2, 3 dhe 4 të nenin 4, parashikon qart si më poshtë vijon:

2. *Deklarata e Njohjes së Konformitetit, e cila i lëshohet për herë të parë një subjekti aplikant, është e vlefshme edhe për çdo subjekt tjetër, i cili kërkon të importojë, ose të vendosë në treg pajisje të të njëjtit tip. Proçesi i njohjes së konformitetit që kryhet për herë të parë është i vlefshëm për të gjitha pajisjet radio dhe pajisjet fundore të telekomunikacioneve identike, pavarësisht nga subjekti aplikant.*
3. *Pajisjet radio dhe pajisjet fundore të telekomunikacioneve që kanë kaluar në procedurën e miratimit të tipit përfshihen në një listë që përditesohet rregullisht, e cila publikohet në faqen zyrtare të AKEP-it në internet www.akep.al. Për importimin dhe futjen në treg të pajisjeve të kësaj liste nuk është e nevojshme që subjektet të kryejnë procedurën e njohjes së konformitetit.*
4. *Për subjektet jo tregtare dhe përdoruese të pajisjeve radio e pajisjeve fundore të telekomunikacioneve, proçesi i Miratimit të Tipit është i detyrueshëm vetëm për ato pajisje, të cilat nuk përfshihen në liste dhe që për herë të parë importohen në Shqipëri.*

AKEP, për sa më sipër konsideron si të pa nevojshëm shtimin e paragrafit të sygjeruar nga Eagle Mobile.

6. Në lidhje me pretendimin e Eagle Mobile për heqjen e paragrafit 17.1 “*Dhënia e informacionit*”, AKEP e konsideron si të pabazuar pasi kjo pikë e RIO është në zbatim të nenit 16 “*Detyrimi për të dhënë informacion*”, të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”;
7. AKEP, mbi sygjerimin e Eagle Mobile në pikën 20 “*Shkelja, pezullimi dhe zgjidhja e mosmarrëveshjes së interkoneksionit*”, çmon se kjo pikë e RIO është plotësisht e bazuar në Rregullore “Për Aksesin dhe Interkoneksionin” ku janë përcaktuar qartë llojet e shkeljeve dhe masat për pezullim apo zgjidhje të marrëveshjes së interkoneksionit midis palëve;
8. AKEP, mbi ndryshimin e propozuar të Eagle Mobile në pikën 21.6 “*Garancia Financiare*”, konsideron se parashikimi aktual përcakton në mënyrë adekuate dhe ligjore vlerën e garancisë financiare dhe llogaritjen e saj;
9. AKEP, në lidhje sygjerimin e Eagle Mobile për shtimin e një pikë 3.2.3.8/1 të Aneksit III “*Faturimi dhe pagesat*” ku të përcaktohet mënyra e faturimit për diferenca me shumë se 1%, e vlerëson si me efçente standartin e parashikuar në RIO-n aktuale, duke konsideruar dhe sensitivitetin e këtij parashikimi për të gjitha palët të cilat shfaqin një interes të ligjshëm dhe komercial mbi RIO-n;
10. Për sa i përket sygjerimit të Eagle Mobile në Aneksin V “*Numeracioni dhe CLI*” AKEP vlerëson se Aneksi V është në përputhje të plotë dhe në zbatim të pikës 9 dhe 10 të nenit 5 të Rregullores “Për Aksesin dhe Interkoneksionin” ku janë të përcaktuara qart procedurat që duhet të ndjekin palët në rastet e shkeljes së detyrimeve për CLI;
11. Në lidhje me komentet e Eagle Mobile mbi SLA konkretisht në pikat 10.1, 10.2 dhe 10.3, AKEP i konsideron këto pika të RIO-s së miratuar, si të bazuara dhe në përputhje me parashikimet e pikës 9 të “Marrëveshja e nivelit të shërbimit”, nenit 20 të Ofertës Referencë të Interkoneksionit;
12. AKEP, për sa i përket afatit të vlefshmërisë, në Ofertë Referencën e Interkoneksion, vlerëson si të efektshëm dhe të dobishëm parashikimin aktual duke e hartuar RIO-në si një dokument me afat të pacaktuar deri në momentet kur kërkohen ndryshime në kuadrin rregullator,

P Ë R K Ë T O A R S Y E :

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 135 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendshme,

V E N D O S :

1. Të pranojë pjesërisht kërkesën ankimore nr. 250 prot, datë 21.01.2010 të Eagle Mobile sh.a;
2. Pika 6, 6.3 e dokumentit RIO e Eagle Mobile të ndryshohet si më poshtë vijon:

“Për të shmangur çdo dyshim në lidhje me Marrëveshjen e Interkoneksionit, palët kanë detyrimin t’i përcjellin njera-tjetrës vetëm thirrje të përcaktuara në këtë ORI, apo thirrje për të cilat palët kanë rënë dakort.

3. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit te AKEP: www.akep.al
Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARET:

- 1. Alketa MUKAVELATI**
- 2. Benon PALOKA**
- 3. Ibsen ELEZI**
- 4. Zamira NURCE**